



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJSH
MUJ I SHKURT



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

<http://femijetetiranes.al/>

Kuriozitetë për muajin SHKURT



Çfarë duhet të dimë për muajin Shkurt?

- **Shkurti** është muaji i fundit i stinës së dimrit dhe muaji i dytë i vitit.
- Muaji Shkurt quhet i tillë, sepse është muaji me më pak ditë i vitit.
- Muaji Shkurt ka 28 ditë dhe një herë në katër vjet ka 29 ditë. Viti ku muaji Shkurt ka 29 ditë është i njohur edhe si “Viti i Brishtë”.
- Në muajin Shkurt fillojnë të çelin lulet e para të pranverës si: lule mimoza, manushaqja, lulja e qershisë etj.

Muaji Shkurt – “Përrallat dhe personazhet e tyre”
Grupmosha: 18-24 muajsh



Java I: Bota e përrallave.

Java II: Personazhet më të dashur të përrallave.



Java III: Bota e kafshëve përmes përrallave.

Java IV: Teatri i kukullave.





Tema Mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Bota e përrallave.	Njohja e fëmijëve me botën e përrallave dhe personazhet kryesorë të tyre.	Java I
Personazhet më të dashur të përrallave.	Njohja me përrallat klasike, shqiptare dhe ato të reja. Emocionet që përjetojmë kur lexojmë përrallat dhe njohja me veshjet e personazheve.	Java II
Bota e kafshëve përmes përrallave.	Njohja e kafshëve përmes përrallave: kafshët shtëpiake, kafshët e pyllit, bota ujore dhe e insekteve.	Java III
Teatri i kukullave.	Njohja me teatrin e kukullave, përgatitja e një shfaqjeje teatrale në çerdhe.	Java IV




Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Bota e përrallave			
Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	<p>Njohja me botën e përrallave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u tregon fëmijëve libra të ndryshëm me përralla nga ato që kanë në grup, duke i'u folur rreth karakteristikave të secilit.</p> <p>Vjersha: “Flutura”.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një përralle nëpërmjet figurave të prera nga revista/libra me përralla. Formoni përrallën e zgjedhur, bashkë me fëmijët ndërkohë ritregoni përrallën me fjalët tuaja (zgjedhja e përrallës lihet e lirë).</p>	<p>-Mjete didaktike: Libra, revista me përralla, pazëll. -Manuali i vjershave</p>
E Martë	<p>Personazhet e përrallave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u flet fëmijëve mbi personazhet më të njohur të përrallave si: ” Kësulkuqja, Tre Derrkucët, Macoku me Çizme”, etj</p> <p>Përralla: “Tre Derrkucët”</p> <p>Aktiviteti: Ngjitja në fletë e personazheve të preferuar të përrallave, të prera nga librat me përralla.</p> <p>Loja: Ndërtojmë me blloqe dhe kuba me ngjyra të ndryshme shtëpitë e derrkucëve.</p>	<p>-Mjete didaktike: fletë më personazhet e përrallave, lapsa me ngjyra etj.</p>




<p>E Mërkurë</p>	<p>Librat</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rëndësinë e librave dhe si të kujdesemi për to.</p> <p>Kënga lëvizore: “Familja e gishtave”</p> <p>Loja: Libri jam unë. (Edukatorja së bashku me fëmijët krijon një libër me punimet e fëmijëve në çerdhe).</p>	<p>Mjete didaktike:kartona/ letra me ngjyra/ngjitës, figura Manuali i vjershave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Gjumi dhe përrallat</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rëndësinë e gjumit dhe leximit të përrallave para gjumit, që fëmijët të bëjnë një gjumë të qetë.</p> <p>Lojë: Vendosija e kukullës në gjumë.</p> <p>Vjersha: “Sara e vogël”/“Bubi vogël” (Vjersha shoqëron vënieën e kukullës në gjumë).</p> <p>Aktivitet:Krijimi i shtëpisë së Bubit me mjete të riciklueshme.</p>	<p>-Mjete didaktike:kartona/ letra me ngjyra/ngjitës. -Manuali i vjershave.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Emocionet në përralla</p> 	<p>Bisedë:Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve katër emocionet bazë: i/e gëzuar, i/e mërzhitur, i/e habitur, i/e zemëruar. Zbulojmë së bashku këto emocione në përrallën “Rosaku i shëmtuar”.</p> <p>Përralla: “Rosaku i shëmtuar”.</p> <p>Aktiviteti: Imitimi i emocioneve me fytyrë, improvizuar nga</p>	<p>-Mjete didaktike: libra,revista, tullumbace, etj -Manuali i vjershave</p>




		<p>edukatorët. Edukatorja ndihmon fëmijët të imitojnë emocionet që ajo i'u demonstron.</p> <p>Loja: Demonstrimi i emocioneve me tullumbuce me ngjyra të ndryshme.</p>	
--	--	--	--


Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Personazhet më të dashur të përrallave.			
Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	Përrallat klasike 	<p>Bisedë:Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve personazhet kryesorë të përrallave klasike si: “Borëbardha”, Kësulëkuqja, “Pinoku” etj</p> <p>Aktivitet 1: Leximi i përrallës “Pinoku” në grup. Edukatorja ndihmon fëmijët të kuptojnë (mesazhin e përrallës), pse pinokut i’u rrit hunda dhe pse nuk duhet të gënjejnë .</p> <p>Aktivitet 2: Krijojmë me punë dore fytyrën e Pinokut dhe hundën e krijojmë përmes kubave,(sa herë Pinoku gënjen) kur hunda rritet (si në figurë).</p> <p>Kënga : “Kënga e pinokut”.</p>	Libra/ Revista të ndryshme Manuali vjershave dhe i këngëve 



<p>E Martë</p>	<p>Përrallat e reja</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u flet fëmijëve mbi përrallat e reja si: “Maçoku me Çizme”, “ Mbretereshat e Dëborës”, “Bambi”, “Derrkucja Pepa”</p> <p>Përralla: “Derrkucja Pepa’</p> <p>Aktivitet:Ngjyrosja, prerja dhe ngjitja e personazheve të Derrkucës Pepa në këndin e aktiviteteve.</p> <p>Kënga : “Kënga e pinokut”</p> <p>Loja: Gjuajtja në shenjë (loja me birrila).</p>	<p>-Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fleta.</p> <p>-Manuali vjershave dhe këngëve</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përrallat shqiptare: përrallat me kafshë.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve përrallat me kafshë, personazhet kryesorë të tyre si “Dhelpra dhe lejleku”, “Çufo dhe Bubi Kaçurrel”.</p> <p>Përralla: “Dhelpra dhe lejleku”</p> <p>Aktiviteti: Vizatim/ngjyrosje e personazheve të Dhelprës, Lejlekut, Çufos, etj.</p> <p>Loja: “Çova një letër në postë”, loja me karrige apo me birila.</p>	<p>- Mjete didaktike</p> <p>-Manuali vjershave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Përrallat shqiptare: përrallat me personazhe.</p>	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve mbi përrallat shqiptare si “Pipiruku”, “Arushi që kërkonte babanë” “Fatbardh pikaloshi”, personazhet kryesorë të tyre.</p> <p>Kënga: “Pipiruku”.</p>	<p>Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, plastelinë</p>

		<p>Aktiviteti: Fëmijët ngjyrosin/punojnë me plastelinë personazhin e milingonës.</p>	
<p>E Premte</p>	<p>Parada me veshjet e personazheve të përrallave.</p> 	<p>Aktivitet : Krijimi i veshjeve, maskave të personazheve të përrallave me plastelinë ose karton. Fëmijët “bëjnë sikur” imitojnë personazhin e maskës që kanë vendosur.</p> <p>Përsëritje e përrallave, vjershave, këngëve të zhvilluara gjatë javës.</p>	<p>Mjete didaktike: karton plastelinë, ngjyra.</p>

Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Bota e kafshëve përmes përrallave.			
Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	<p>Kafshët shtëpiake.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve kafshët shtëpiake si: qeni, macja, kali, lopa, derrkuci, delja, dhia etj. Ju tregon ku jetojnë ato dhe fëmijët imitojnë tingujt e tyre etj.</p> <p>Vjershë:“Ga-ga-ga ja bën pata”,“Lopa, dhia dhe delja”</p> <p>Loja: Hedhja e kubit (ku në çdo faqe të kubit ka figura kafshësh, tingujt e të cilave fëmijët i imitojnë).</p>	<p>Mjete didaktike: Karton me ngjyra dhe figura kafshësh.</p> 
E Martë	<p>Kafshët e pyllit</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve rreth kafshëve që jetojnë në pyll (lepuri, ariu, ujku, dhelpra, kaprolli, etj)/ demostrojnë tingujt që lëshojnë ato.</p> <p>Aktivitet: Krijimi i kafshëve me plastelinë me ndihmën e edukatores.</p> <p>Përralla: “Mbreti Luan”.</p> <p>Këngë lëvizore : “Plaku Donald ka një Fermë”</p>	<p>Libri “Mbreti Luan”.</p> <p>Tabela Lotos</p>

<p>E Mërkurë</p>	<p>Bota ujore.</p> 	<p>Bisedë:Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve botën ujore si peshqit, balenat, delfinët. Ajo ju tregon fëmijëve se ato jetojnë në det, lumë, liqen, oqean.</p> <p>Vjersha: “Dy peshqit e kuq”, “Ylli i detit “.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një akuariumi me peshq, guacka me mjete të riciklueshme etj.</p> <p>Loja: Të shkojmë për peshkim (improvizim i një dite peshkimi)</p>	<p>-Mjete didaktike: letra, ngjyra, figura, kartona etj.</p> <p>-Manuali vjershave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Bota e insekteve.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve insektet si mizat, milingonat, buburrecat, merimangat, fluturat.</p> <p>Vjersha: “Bleta”</p> <p>Aktiviteti:Pikturimi me duar, këmbë dhe gishtat e fëmijëve i insekteve të ndryshme (si për shembull: nusepashka, bleta dhe flutura).</p> <p>Loja energjike: Tuneli. Improvizimi i tunelit përmes rrathëve.</p>	<p>-Manuali i vjershave</p> <p>-Mjete didaktike.</p> <p>Kartona,ngjyra etj</p> 

<p>E Premte</p>	<p>(Loja me e bukur për mua)</p> 	<p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modele personazhesh të ndryshme të përrallave, krijuara më parë nga edukatorët.</p> <p>Aktivitet: Edukatorët me fëmijët në grupe kërcëjnë/ improvizojnë përmes këngëve lëvizore (Tingujt e kafshëve, kënga e lejlekut).</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p>
------------------------	---	---	--

Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Teatri i kukullave.			
Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Teatri i kukullave 	Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet/shpjegon fëmijëve për teatrin e kukullave dhe si është i ndërtuar ai. Përralla: (E lirë). Të demonstrohet në teatrin e improvizuar nga edukatoret. Këngë lëvizore: “Nëse je vërtet i lumtur”.	-Mjete didaktike: çarçaf, karton, kuti, kukulla të ndryshme etj.
E Martë	Një shfaqje me animator. 	Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet/ shpjegon fëmijëve rreth animatorëve. Edukatorja pyet: A keni qënë ndonjëherë në ndonjë festë me animatore? Aktiviteti: Improvizojmë një festë me kostume animatorësh. Vjersha: “Lopa, dhia dhe delja”. Lojë: Lojë energjike, kalimi i pengesave.	-Manuali vjershave dhe këngëve

<p>E Mërkurë</p>	<p>Lepuri dhe Breshka</p> 	<p>Përrallë: Leximi i përrallës , “Lepuri dhe Breshka”.</p> <p>Aktiviteti : Krijimi me punë dore i elementëve të përrallës “Lepuri dhe Breshka”.</p> <p>Këngë lëvizore: “Tingujt e kafshëve”</p> <p>Loja:“Topi në kosh sipas ngjyrave”,</p>	<p>-Mjete didaktike</p> <p>Kartona me ngjyra, lapsa,gërshërë,ngjites.</p> <p>-Manuali vjershave dhe këngëve</p> <p>-Magnetofon për muzikë</p>
<p>E Enjte</p>		<p>Përrallë: Leximi i përrallës “Bambi”.</p> <p>Aktiviteti:Bërja e topit me plastelinë/ fije dhe hedhja e tij në koshin/ gotën përkatëse sipas ngjyrave.</p> <p>Këngë lëvizore: “ Kënga e lejlekut.”</p>	<p>Manuali vjershave dhe këngëve.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Aktivitet i lirë</p> 	<p>Përralla : Leximi ose shikimi në PC/ projektor i përrallës “Maçoku me çizme”.</p> <p>Aktivitet i lirë: Këngë ritmike, fëmijët kërcëjnë të gjithë në grup.</p> <p>Lojra energjike: Organizimi i lojrave më të pëlqyera.</p>	<p>-Magnetofon, cd me muzikë</p> <p>-Manuali i lojërave</p>